

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" Guest House Çoba " SHPK

Sot date 13.06.2022, Ne shtetasit:

1. **Bujar Çoba**, atesia Qazim, datelindjes 20.05.1985, lindur Puke e me banim Tirane ,Hallias, mbajtes leternjoftimit I50520080A.
2. **Migena Çoba**, atesia Petrit ,datelindjes 28.12.1994, shtetase Shqiptare, lindur ne Puke e me banim ne Tirane,Yzberisht, mbajtese e leternjoftimit J46228036K me cilesine e "Ortakeve Themelues", kemi redaktuar kete akti themelimi, nepemjet te cilit deklarojme se me vullnet të lire, të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin " Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per shoqerite tregtare ", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojme shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "Guest House Çoba " SHPK

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "Guest House Çoba " SHPK

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria,eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria,eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket te cilet përballojne humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne ne Shkoder,Puke ,fshati Qeret, numuri i pasurise 154/7, zona kadastrale 3104.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Ne fushen e turizmit:

Investime ne turizem rural, hapje axhensi turistike, bujtine, bar kafe, restaurant, hoteleri.

Ne fushen e tregetise:

Import, eksport, tregetim me shumice e pakice te artikujve qe lejohen me ligj.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100. 000 lekë dhe eshte i ndare në 2 /dy/ kuote/.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortakët e shoqerise perkatesisht :

Bujar Coba, kuota me vlere te pergjithshme 51.000 Leke, qe perbejne 1 kuota 51 % te kapitalit te shoqerise,

Migena Coba, kuota me vlere te pergjithshme 49.000 Leke, qe perbejne 1 kuota e 49 %, te kapitalit te shoqerise

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese së ortakëve *Secili nga ortakët ka te drejte te bleje kuoten e pjesmarrjes ne shoqeri qe ortaku tjeter (ketej e me poshte i quajtur dhenesi) ka nder mend te jape me tituj detyrimi ose gratis.* Dhenesi duhet t'ju komunikojë ortakëve të tjerë, në adresën që rezulton në librin e ortakëve, synimin për të dhënë kuotat e tij, duke treguar pranuesin dhe modalitetet e negociimit të transferimit. Brenda 30 diteve nga marrja e këtij komunikimi, ortakët duhet të dergojnë një komunikim dhenesit duke deklaruar se duan të blejnë të tere kuoten, objekt i transferimit. Në mungesë, kuota mund të transferohet pranuesit . Nëse me shume ortakë deklarojne se duan te blejne, ata duhet te behen bleres te kuotave ne fjale, ne proporcion me kuotat qe ata kane ne shoqeri. Ne komunikimin qe do ti bejne dhenesit, ortakët qe duan te blejne kuotat do te kene te drejten per te paraqitur afatin brenda te cilit do te procedojne per blerjen e pjesmarrjes shoqerore.

Ky afat nuk mund te jete me i madh se 3 muaj nga data qe i eshte derguar komunikimi dhenesit.

Me qellim ushtrimin e te drejtes se blerjes, cmimi percaktohet ne baze te situates pasurore te shoqerise, rendimentit te saj, vleres se te mirave materiale dhe jo materiale ne pronesi te saj si dhe cdo rrethane apo kushti qe merret ne konsiderate per te percaktuar vleren e pjesemarrjes shoqerore. Ne mungese te nje marreveshje mbi cmimin ne baze te ketij kriteri, ai do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga Gjykata e qytetit ne te cilen shoqeria ka seline.

Te gjitha komunikimet si me siper duhet te behen me leter rekomande ose te dorezuar ne dore dhe te kunderfirmosura. *Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.*

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Vendimet merren pas konsultimit me shkrim të ortakëve, në rast se ortakët miratojnë me shkrim përmbajtjen e konsultimit.

Ortakët lajmërohen me letër rekomande të paktën 7 ditë përpara mbledhjes së asamblesë. Në këtë letër njoftohet rendi i ditës. Lajmërimi bëhet nga administratori ose njeri prej ortakëve.

Asambleja do te jete e vlefshme edhe pse nuk eshte mbledhur ne peputhje me dispozitat si me siper nese ne marrjen e vendimit perkates te kete marre pjese i gjithë kapitali shoqeror dhe te gjithë adminstratorët, nese jane emeruar, te jene te pranishem ose te informuar per mbledhjen dhe asnje nuk kundershton trajtimin e argumentit. Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Secili ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër. Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nepermjet prokures.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit (si transferimi i kapitalit, zmadhimi i kapitalit shoqeror, financimet etj,) duhet detyrimisht te vendosen me miratimin e ortakëve.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakëve.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Ortakët vendosin për sistemin e administrimit dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratore, përcaktojnë numrin dhe kompetencat e tyre.

Administratori/administratores, mund të jenë ose jo ortakë të shoqërisë. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë. **Administrator i shoqërisë është Bujar Çoba.**

Administratori i shoqërisë emerohet në këto detyra dhe ka kompetencat për një periudhë të përcaktuar sipas ligjit. (pese vjeçar)

Neni 11

Kompetencat

Shoqëria administrohet nga Administratori. Administratori është i pajisur me kompetencat me të gjera për menaxhimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre operacioneve kur në ligj ose nëpërmjet këtij statuti i është rezervuar vendimeve të ortakëve.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, vec e vec ose se bashku, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori ka gjithashtu të drejtë të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajë e hartojë çdo dokument e të kryejë në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Liqjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne akt, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 15

Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e statudit, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise nenshkruset ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale.

CEL 069 84 76 191

Bujar Caba


ORTAKËT
Mijena Caba
